



PRISHTINA



Komuna e Prishtinës

Drejtoria e Shërbimeve Publike

Spektori për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit

Me kërkesë të drejtorisë, për vlerësimin e gjendjes së Menaxhimit të Mbeturinave në territorin e Komunës së Prishtinës, zyrtarët e përcaktuar: Shkurta Zariqi – Zyrtare e lartë për Menaxhimin e Mbeturinave; Lumnije Hyseni – Zyrtare për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Donat Gashi – Zyrtar Mbështetës hartojnë këtë:

RAPORT

(për gjendjen e Menaxhimit të Mbeturinave në Komunën e Prishtinës)

Raporti përshkruan nivelin e ofrimit të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave nga bizneset, institucionet dhe ekonomitë familjare dhe përfshinë periudhën nga data: 15 janar 2025 deri më sot.

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur ankesa të formave të ndryshme nga të gjitha kategoritë e lartpërmendura, për nivelin e ofrimit të shërbimit, nivel i cili është në diskrepancë të plotë me legjislacionin në fuqi. Ky nivel i shërbimit me vonesa në ofrimin e shërbimit me javë të tëra, rrjedhje të kamionëve, mund të shkaktoj rrezikim të shëndetit publik. Kjo formë e operimit, nuk

ka kursyer as institucionet me veprimtari të ndijshme siç janë Qendrat e Mjekësive Familjare, ku shërbimi i grumbullimit të mbeturinave është në gjendje kaosi.

Niveli i dobët i ofrimit të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, është përshkallëzuar sidomos pas përfundimit të kontratës së operatorit privat, duke shkaktuar kaos të plotë në tërë qytetin, si në pikat e grumbullimit kolektiv të mbeturinave, ashtu edhe në lagjet ku shërbimi ofrohet 'derë më derë', duke rezultuar në krijimin e deponive të vogla, të panumërta, përgjatë tërë territorit të komunës së Prishtinës.

Me gjendjen momentale të makinerive dhe numrit të kufizuar të tyre, mund të konstatojmë se komuna e Prishtinës, momentalisht është duke u ballafaquar me sfida serioze në ofrimin e shërbimit bazik dhe nuk mund të pretendojmë në përmirësimin e këtij shërbimi siç parashihet në Planin Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave dhe Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave.

E vetmja sferë ku mund të pretendojmë që kemi bërë progres për dallim nga gjendja paraprake, është ajo me menaxhimin e mbeturinave të vëllimshme dhe atyre nga ndërtimi dhe demolimi. Megjithatë, duhet të potencojmë se edhe në këtë sferë kemi ende pasojat e menaxhimit të dobët që është bërë para angazhimit të kompanive të specializuara, ku në qendër të Prishtinës ende kemi një deponi gjigande me përmbajtje kryesisht të mbeturinave të vëllimshme dhe atyre nga ndërtimi dhe demolimi.



Deponia në afërsi të NPL Trafiku Urban e shkaktuar nga KRM Pastrimi

Ofrimi i shërbimit ndaj bizneseve

Ofrimi i shërbimit ndaj bizneseve është në gjendje jashtëzakonisht të keqe, duke mos respektuar as orarin e shërbimit të përcaktuar, e as mënyrën e grumbullimit të mbeturinave, siç parashihet në Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave. Kjo ka rezultuar që shumica e bizneseve që operojnë në territorin e komunës së Prishtinës, të shkelin rregulloren në fjalë, duke lidhur kontrata me operator të paautorizuar për të operuar në komunën e Prishtinës. Edhe bizneset të cilat kanë të lidhur kontratë me KRM "Pastrimi", nuk respektojnë Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave, pasi që hedhjen e mbeturinave nuk e bëjnë në përputhje me këtë rregullore, duke shfrytëzuar kontejnerët publik, të dedikuar për ekonomi familjare. Në lokacionet në të cilat kontejnerët publik janë larg, bizneset detyrohen që mbeturinat t'i hedhin në hapësira të papërshtatshme apo t'i bartin në distanca të largëta. Ofrimi i shërbimit për grumbullim të veçantë të mbeturinave specifike (mbeturinave të kompostueshme, mbeturinave të riciklueshme, vajërave etj.) me gjendjen momentale të operimit është i parealizueshëm, edhe pse një gjë e tillë parashihet në Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave. Andaj, mund të konstatojmë se menaxhimi i mbeturinave të krijuara nga bizneset është tërësisht jashtë planifikimeve të komunës së Prishtinës dhe në shpërputhje të plotë me zotimet të cilat i kemi bërë si institucion me Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave të vitit 2023.



Rruga "Hilmi Rakovica"



Rruga "Ibrahim Lutfiu"

Ofrimi i shërbimit ndaj institucioneve

Gjendje po aq e rëndë është edhe sa i përket ofrimit të këtij shërbimi ndaj institucioneve. Kjo ka rezultuar që në shumicën e institucioneve, përveç atyre lokale, shërbimi të ofrohet nga kompani të paaautorizuara për të operuar në territorin e komunës së Prishtinës. Edhe në institucionet lokale si QKMF-të, shkollat apo objektet e tjera komunale, në të cilat operon KRM "Pastrimi", gjendja në shumë raste është para kolapsit. Si ilustrim për këtë Raport, mund të marrim Qendrën e Mjekësisë Familjare në lagjen Kodra e Trimave, e cila ofron edhe shërbimin e Dializës, si shërbim shumë të ndijshëm, e në të cilën shërbimi i grumbullimit të mbeturinave të krijuara nga kjo qendër ishte buzë kolapsit, duke shkaktuar problem serioz dhe shqetësim të stafit të kësaj qendre dhe rrezikim të funksionimit të mirëfilltë të saj.

Si dëshmi të gjendjes reale të përshkruar, kemi bashkangjitur disa fotografi, përmes së cilës mund të shihet gjendja e krijuar në këtë qendër.

Gjendje e njëjtë me menaxhimin e mbeturinave, është edhe në shkollat fillore dhe të mesme ku shërbimi i grumbullimit të mbeturinave, bëhet me vonesa të shumta, pa respektuar një orar të caktuar për grumbullimin e tyre. Gjithashtu, në lokacionet e grumbullimit të mbeturinave, të cilat gjenden në afërsi të shkollave mosrespektimi i orarit, përveç që krijon pamje të shëmtuara, në raste të caktuara përbën edhe rrezik për kalimin e sigurt të nxënësve, sepse trotualet janë të bllokuara nga mbeturinat. Një gjendje e tillë, krijon terren të përshtatshëm edhe për qentë endacak, të cilët shqyejnë qeset e mbeturinave dhe i shpërndajnë gjithandej, e kjo mund të shkaktoj rrezik edhe për përhapjen e ndonjë sëmundje dhe rrezikim të shëndetit dhe sigurisë së qytetarëve.



Rruga "Xheladin Kurbaliu -QKMF"



Lagja "Kodra e Trimave"



Lagja "Muhaxher"



Lagja "Kodra e Trimave"

Ofrimi i shërbimit ndaj ekonomive familjare

Ndikimi më i madh në mjedis me këtë nivel të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave është tek ekonomitë familjare, si shërbimi 'derë më derë' ashtu edhe ai përmes kontejnerëve publik. Degradimi në ofrimin e këtij shërbimi, pas një stabiliteti të krijuar përmes angazhimit të operatorit privat vërehet shumë, me theks të veçantë në javën e fundit. Gjithandej në zonën urbane por edhe në zonën rurale, kemi kontejner të stërmbrushur, e cila po krijon pamje të shëmtuar të pikave të grumbullimit të mbeturinave. Këto mbeturina nga era po shpërndahen edhe në hapësirat përreth, duke na krijuar kosto shtesë për pastrimin e rrugëve dhe hapësirave publike. Një gjendje

pothuajse e njëjtë është edhe me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave 'derë më derë', ku vonesat janë edhe me javë të tëra. Ky nivel i shërbimit nuk përkon aspak me Planin Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave, e po ashtu nuk i përmbushë standardet e përcaktuara në Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave, pasi që vet ofruesi i shërbimit, në mënyrë indirekte është duke shkaktuar ndotje. Kjo ka rezultuar që vetëm gjatë muajit janar të kemi me qindra ankesa, të pranuar në forma të ndryshme.

Të gjitha problematikat e paraqitura më lartë, dëshmojnë edhe nga fotografitë e gjendjes në terren, e të cilat janë pjesë e këtij Raporti.



Rruga "Sylejman Vokshi"



Rruga "Ali Vitija"



Rruga "Shaqir Igrishta"



Rruga "Arkitekt Karl Gega"



Rruga "Esad Mekuli"



Rruga "27 Nëntori"



Rruga "Naim Frashëri"

Ky raport u hartua nga:

1. Shkurta Zariqi - Zyrtare e Lartë për Menaxhimin e Mbeturinave
2. Lumnije Hyseni - Zyrtare për Menaxhimin e Mbeturinave
3. Donat Gashi - Zyrtar Mbështetës

Shkurta Zariqi

Lumnije Hyseni

Donat Gashi